

N j o f t i m P u b l i k

Në drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar aplikacioni **05 Nr.350/02-35468/26 dt.10.03.2026**, në emër të pronarëve: Isa Dukaj, Sabri Gashi, Arbreshe Kelmendi, Sabri Zeqiri, Gani Zeqiri, Mexhid Zeqiri, Agron Muja, Abedin Mehmeti, Ali Asani, Afrim Muji, Besnik Kryeziu, Arben Hajdaraj, Luljeta Nitaj, Arber Kelmendi dhe Mentor Gashi nga Prishtina dhe Investitori “EURO - BESI” Sh.P.K. nga Prishtina me certifikatë të biznesit ARBK 810197849, me përfaqësues Sadik Krapit nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimore / projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesave shumë banesore & afariste – Lamela “1” me B+S+P+3, Lamela “2” me B+S+P+3, Lamela “3” me B+S+P+3 dhe Lamela “4” me B+P+3 në kuadër të Planit Zhvillimor Urban-PZHU, në Prishtinë, konkretisht nr. të parcelave: nr.1530-0 ZK Matičan, sipas projekt propozimit / Planit të situacionit - “zgjidhjes urbane” të prezantuar.

Me aplikacion është prezantuar edhe projekt propozimi për ndërtimin e kompleksit të lartcekur. Bazuar në pikën 2 të nënit 18 të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, “Organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së lejes së ndërtimit”. Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **31.03.2026** deri me datën **14.04.2026** në e-mail adresën: urbanizmi@prishtine@rks-gov.net.

Kushtet e propozuara: Ndërtesa shumë banesore & afariste – Lamela “1” me B+S+P+3, Lamela “2” me B+S+P+3, Lamela “3” me B+S+P+3 dhe Lamela “4” me B+P+3	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtim i mesëm; Etazhiteti I-IV I propozuar: Ndërtim i mesëm., B+S+P+3
b. Vija rregulluese	Kufiri i parcelës kadastrale / Rruga ekzistuese 5 m’
c. Vija ndërtimore	Jo më pak se 5m për rrugë me gjerësi deri 7m Jo më pak se 7.5 m për rrugë me gjerësi deri 7-15 m Jo më pak se 10 m për rrugë me gjerësi mbi 15m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	7.5 m’ / P+4
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	Anësor: 0.5H/17.10m’ , 0.5H/15.00m’ Pasmë : 0.5H/13m’
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	40% -3.335.60 m² e lejuar, 28.57% - 2,383.21 m² e propozuar.
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	Koeficienti 1.2 – S=10.006.8 m² e lejuar, S=9,994.32 m² sip. ndërtimore mbi tokë e propozuar
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40% - ose S=3,335.60m² i lejuar dhe S=4,067.95m² në tokë & 598.02m² në kulm e terasa e propozuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60% ose S=5.003.40 m² epakufizuar e lejuar dhe S=2659.93m² - propozuar,
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	104 VP në ndërtesa
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - ☒ Jo - ☐ Nuk aplikohet - ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet tuaja duhet të përsëritet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit: